



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.32.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
HANIT TË ELEZIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunitetit të Kosovës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Enver Ramadani Udhëheqës i Ekipit të Auditimit, dhe Fetah Osmani e Hysen Restelica - Anëtarë, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Mujë Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	18
5 Qeverisja e mirë.....	19
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	22
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	25
Shtojca III: Letër konfirmimi	30

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 27/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e komunës, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i Çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

- Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 24,821€, ishin realizuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale; dhe
- Informatat e shpalosura në Pasqyrat Financiare Vjetore në lidhje me pasuritë nuk janë të sakta.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 24,821€, në emër të projektit¹ për realizimin e shërbimeve shëndetësore, ishin realizuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale; dhe
- Tri projekte² të përfunduara në vlerë totale 322,000€, ishin të regjistruara gabimisht si investime në vijim. Si rrjedhojë nuk është kalkuluar zhvlerësimi në vlerë 10,175€, duke mbivlerësuar pasuritë neto të komunës. Po ashtu pesë objekte³, si dhe dy pagesa për investime kapitale për “Ndërtimin e shtratit në Përroin e Rezhancës” në vlerë 8,712€ dhe pagesa “Furnizim më pajisje” në vlerë 11,052€, nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël të pasurisë.

Opinionin jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet

¹ Projekti për përkujdesje shëndetësore me Caritas Kosova.

² Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore Ilaz Thaçi” në vlerë 237,000€, “Shtrimi më kubëza betoni të rrugicave” në vlerë 25,000€, si dhe “Ndërtimi i Përroit të Rezhancës” në vlerë 60,000€.

³ Objekti i shkollës së mesme “Dardania” e financuar nga MASHT, Objekti i shkollës fillore “Kështjella e Diturisë” në fshatin Paldenicë, si dhe Objekti i shkollës fillore “Veli Ballazhi” në fshatin Gorancë, Objekti i sallës së edukatës fizike i financuar nga BE, si dhe Qendra për punë sociale e bashkëfinancuar më Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Nëse Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar me kohë;
- Harmonizimet tremujore të shpenzimeve dhe te hyrave me Thesarin;
- Raportin e kontratave të nënshkruara të prokurimit; dhe
- Nëse komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe një kopje tek MF.

Komuna e Hanit të Elezit kishte përgatitur dhe dorëzuar PFV-të brenda afatit ligjor në MF. Si pasojë e disa gabime të identifikuar, komuna kishte korrigjuar PFV-të duke përmirësuar raportimin e tyre, megjithatë edhe pas korrigjimit, ne kemi identifikuar disa gabime të cilat janë shpallur te theksimi i çështjes të opinionit të auditimit.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, si dhe të merren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar regjistrimin e plotë të pasurive dhe për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve.

Gjithashtu, duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna kishte shpenzuar 90% të buxhetit final për vitin 2017, që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm, megjithëse niveli i shpenzimeve të investimet kapitale ishte i ulët.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për të reaguar në inkasimin e tyre dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve në masë më të madhe. Përmirësime kërkohen edhe te menaxhimi dhe raportimi i pasurisë. Ndërsa, kontrollet mbi shpenzimet ishin përmirësuar dukshëm në vitin 2017.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ⁴	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	2,406,534	2,694,976	2,422,548	2,189,897	2,094,367
Granti i Qeverisë -Buxheti	2,166,680	2,332,005	2,240,415	1,851,081	1,901,743
Të bartura nga viti paraprak ⁵ -	-	86,192	31,440	106,108	44,134
Të hyrat vetjake ⁶	239,854	239,854	113,852	188,624	94,536
Donacionet e brendshme	-	-	-	-	-
Donacionet e jashtme	-	36,925	36,841	44,084	53,954

⁴ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁵ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁶ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 288,442€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të jashtme prej 36,924€, të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë prej 83,192€ dhe rritja e buxhetit prej 165,325€ në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës të datës 15/12/2017.

Në vitin 2017, Komuna ka shpenzuar 90% të buxhetit final ose 2,422,548€, me një nën shpenzim prej 5% krahasuar me vitin 2016 (95%). Nëse e shohim realizimin e buxhetit sipas kategorive ekonomike, realizimi ishte në nivel të mirë në të gjitha kategoritë, me përjashtim të investimeve kapitale e cila ishte në nivel më të ulët (në nivel 77%).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	2,406,534	2,694,976	2,422,548	2,189,897	2,094,367
Pagat dhe Mëditjet	1,393,609	1,393,609	1,367,010	1,391,497	1,366,432
Mallrat dhe Shërbimet	180,551	206,591	188,215	211,387	264,565
Shërbimet komunale	44,533	49,989	49,932	48,264	48,061
Subvencionet dhe Transferet	51,104	51,492	49,801	53,159	47,640
Investimet Kapitale	736,737	993,295	767,590	485,590	367,669

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit në vlerë prej 256,558€, vetëm 77% e buxhetit ishte shpenzuar. Niveli i ulët i ekzekutimit në këtë kategori ishte për shkak të aprovimit më vonësë të buxhetit shtesë për 134,831€, me vendimin e qeverisë më datën 15/12/2017;
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime, ishte nga te hyrat e bartura në vlerë prej 545€ dhe nga Qeveria e Kosovës, në vlerën prej 25,494€;
- Rritja e buxhetit për shpenzimet komunale, ishte nga te hyrat e bartura nga viti i kaluar në vlerë prej 456€ dhe nga Qeveria e Kosovës, në vlerën prej 5,000€; dhe
- Rritja e buxhetit për subvencione dhe transfere, ishte nga te hyrat e bartura nga viti i kaluar në vlerë prej 388€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Hanit të Elezit në 2017 ishin në vlerë 225,193€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë në vlerë prej 79,588€ apo 35% nga të hyrat totale, të hyrat nga veprimtaritë bizneseve, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiraja, taksat administrative etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	239,854	239,854	225,193	244,030	223,521
Totali	239,854	239,854	225,193	244,030	223,521

Për sa i përket të hyrave vetanake, mund të shihet se përqindja e realizimit ishte 92% deri në 31 dhjetor 2017, që rezulton më një zvogëlim prej 8% në krahasim më vitin 2016 (244,030€). Të hyrat vetanake janë shfrytëzuar për shpenzime kapitale 79%, mallra dhe shërbime 7% dhe subvencionet dhe transferet 14%. Ndërsa shuma prej 181,518€ është e bartur në vitin 2018. Dobësitë e identifikuar janë paraqitur në vijim:

Çështja 2 - Mos verifikimi i pronave të regjistruara

E gjetura Komuna nuk kishte arritur të kryej ri-anketimin për verifikimin e 1/3-tës së pronave të regjistruara, siç kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi⁷. Komuna kishte 864 prona të regjistruara, mirëpo asnjëra prej tyre nuk ishte ri-anketuar gjatë vitit 2017. Mungesa e ri-anketimit ishte si pasojë e mungesës të zyrtarëve anketues në terren për verifikimin e pronave dhe grumbullimin e informatave.

Rreziku Mos verifikimi i pronave mund të rezultojë me mangësinë që informacioni aktual rreth databazës së tatimit të pronë nuk do të jetë i saktë. Kjo do të ndikojë negativisht në vlerësimin dhe faturimin e tatimit në pronë dhe si rezultat nënvlerësimin e të hyrave nga kjo kategori.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit të pronave dhe të siguroj se verifikimi i 1/3-tës së tyre bëhet në baza të rregullta vjetore, në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara. Rritja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.

⁷ Me UA nr.03/2011 për mbledhjen edhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin, kërkohet që brenda vitit të verifikohet 1/3-ta e pronave të regjistruara.

Çështja 3 – Mos arkëtimi i taksës në biznes

- E gjetura** Nga testimi i shtatë mostrave të taksave në biznes, kemi identifikuar se obligimet e tatimpaguesve ndaj komunës ishin në vlerë 37,361€. Komuna vetëm ndaj një biznesi kishte ngritur procedurë pran gjykatave, kurse ndaj të tjerëve kishte bërë vetëm vërejtje edhe pse më aktvendimet e lëshuara, nga ana e saj, ishte paraparë të ju ndërpres aktivitetin e biznesit.
- Rreziku** Dobësitë e identifikuara mund të rezultojnë me më pak të hyra nga kjo kategori dhe trajtim jo të barabartë të bizneseve. Mosndërmarrja e masave ndëshkuese për të gjitha ato biznese të cilat nuk kanë shlyer obligimet, si taksa në biznes, rritë rrezikun e mosinkasimit të taksave.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë se do të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme kohore të inkasoj të gjitha të arkëtueshmet e saj. Gjithashtu duhet të shqyrtohen në mënyra aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat janë realizuar.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet MF. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë më: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqesin në mes të formularëve; rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin më thesar. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 1,393,609€, ndërsa shpenzimet ishin 1,367,010€, apo shprehur në përqindje rreth 98% e buxhetit final të kësaj kategorie ekonomike. Pjesëmarrja e shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve në shpenzimet totale të komunës është 56%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 256,579€. Prej tyre ishin shpenzuar 238,147€ apo 93% të buxhetit final. Ato kanë të bëjnë me shërbimet komunale 49,932€ apo 21% nga totali i shpenzimeve, furnizimet për zyrë 17,326€ (7%), mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve 14,062€ (6%), furnizimi më dru 18,562€ (8%), dhe karburante për vetura 18,211€ (8%).

Kontrollet në këtë fushë në përgjithësi kanë funksionuar mirë, ku nga testimet e kryera nuk kanë rezultuar më të gjetura.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 51,492€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 49,801€ apo 97% nga buxheti final. Subvencionet e dhëna kanë të bëjnë me përkrahjen financiare nga ana e komunës për fusha dhe aktivitete të ndryshme, si për klube të sportit, shoqëri kulturo artistike, bursa, sektorin e bujqësisë etj. Ne në këtë kategori nuk kemi hasur ne probleme që do të rezultojnë me të gjetura.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 993,295€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 767,590€ apo 77% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve arsimore në vlerë 67,887€(9%), ndërtimin e rrugëve lokale në vlerë 144,091€ (19%), kanalizimeve në vlerë 179,367€ (23%), pajisjet tjera në vlerë 76,199€(10%), rregullimi i lumenjve në vlerë 91,226€(12%), etj.

Dobësitë e identifikuar në këtë fushë janë trajtuar tek theksimi i çështjes, te opiniononi i auditimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime tjera në këtë fushë.

3.7 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Gjatë vitit 2017, komuna ka bërë një progres në aspektin e regjistrimit të pasurive në krahasim me vitin paraprak. Megjithatë edhe përkundër progresit, ende nuk është arritur që regjistri kontabël i pasurive të jetë i saktë. Mos regjistrimi i pasurisë kapitale sipas kategorisë përkatëse është trajtuar tek pjesa e theksimit të çështjes te opiniononi i auditimit, ndërsa në vijim do të paraqiten disa çështje tjera, të cilat komuna do duhej t'i merrte parasysh në vitin 2017.

Çështja 4 – Menaxhim i dobët i pasurive jo financiare

- E gjetura** Pasuria jo kapitale nën 1,000€ e komunës e shpalosur në PFV ishte 77,937€. Sipas rregullores Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë, neni 19, kërkon të bëhet inventarizimi i pasurisë jo financiare, si dhe neni 22 kërkon të bëhet zhvlerësimi i tyre. Ne kemi identifikuar mangësitë si në vijim:
- Komuna nuk ka zhvlerësuar pasuritë jo kapitale më vlerë nën 1,000€, andaj vlera e tyre në PFV ishte e mbivlerësuar. Sipas zyrtareve komunal sistemi e-pasuria nuk është mjaft funksional sepse nuk mundëson përlllogaritjen e zhvlerësimit, që ka rezultuar me shpalosjen jo të saktë të pasurisë në PFV. Gjithashtu në këtë sistem nuk ishin të regjistruara 19 pasuri jo kapitale të blera gjatë vitit 2017 në shumë totale 12,994€; dhe
 - Zyrtari kryesor administrativ kishte formuar komisionin për inventarizimin e pasurisë për vitin 2017, por ai kishte bërë vetëm inventarizimin e pasurisë nën 1,000€ në objektin e komunës dhe në shtëpinë e kulturës, derisa në lokacionet tjera nuk ishte kryer inventarizimi. Përderisa inventarizimi i pasurisë kapitale mbi 1,000€ nuk ishte bërë fare. Me tutje, komisioni për inventarizimin vjetor të pasurive jo kapitale nuk kishte bërë barazimin e regjistrave të inventarizimit me regjistra kontabël të mbajtur nga zyrtaret e pasurive.
- Rreziku** Mos inventarizimi i plotë i pasurisë, shkakton mangësi në menaxhimin dhe raportimin e saktë të pasurisë, duke rrezikuar njëkohësisht keqpërdorimin apo humbjen e pasurive, ndërsa mos regjistrimi i pasurisë dhe mungesa e zhvlerësimit ndikon në mbivlerësimin e vlerës së pasurisë komunale.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të siguroj që në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike, të eliminoj mangësitë në sistemin e-pasuria, përfshirë zhvlerësimin e pasurive si dhe regjistrimin e pasurive të mbetura. Po ashtu, procesi i inventarizimit duhet kryer me kohë, para përgatitjes së PFV-ve, si dhe raporti i inventarizimit duhet të përfshijë krahasimin e gjendjes fizike me atë në gjendjen e regjistrave. Nëse konstatohen diferenca ato duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.

3.8 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të komunës prezantojnë shuma të mjeteve që qytetarët dhe organizatat i detyrohen komunës për shërbimet, punët, mallrat apo pronat që i kanë përfituar nga komuna. Sipas shënimeve të prezantuara në PFV shuma totale e këtyre llogarive në fund të vitit 2017 ishte 511,754€.

Çështja 5 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme

- E gjetura** Komuna nuk kishte ndërmarrë masa aktive për inkasimin e llogarive të arkëtueshme. Borxhet totale ndaj komunës, në fund të vitit 2017 ishin 511,754€ që rezulton më rritje për 13% në raport me vitin 2016 (451,291). Të arkëtueshmet përbehen nga taksat e tatimit në pronë në vlerë 240,577€, taksat nga veprimtaritë e biznesit në vlerë 250,680€, si dhe nga qiratë e pronës komunale prej 20,497€. Kjo është si pasojë e mos vendosjes së mekanizmave adekuatë nga ana e komunës për rritjen e arkëtimit të tyre.
- Rreziku** Mungesa e masave konkrete për të inkasuar llogaritë e arkëtueshme ka rezultuar në rritjen e tyre, dhe rrjedhimisht edhe me humbje financiare për komunën. Gjithashtu, kjo redukton edhe fleksibilitetin e komunës ndaj shpenzimeve të planifikuara që financohen nga të hyrat vetjake.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për inkasimin e të arkëtueshmeve duke i shfrytëzuar të gjitha masat në dispozicion, fillimisht duke i shfrytëzuar të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të komunës, më pas të shfrytëzoj edhe masat tjera ligjore.

3.9 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 12,312€, derisa në vitin 2016 ishin 10,238€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Po ashtu, në fund të vitit janë prezantuar detyrimet kontingjente si konteste gjyqësore në shumë 69,189€, deri sa në vitin paraprak ishin 70,600€.

Komuna në përgjithësi zbaton një proces relativisht të rregullt të raportimit të obligimeve. Zyrtarët komunal janë të vetëdijshëm për kërkesat e rregullores për raportim të faturave të papaguara si dhe zyrtari përgjegjës raporton me kohë në thesar/MF në lidhje me këtë. Megjithatë vlera e obligimeve në raport me vitin paraprak është rritë për 2,074€ ose afërsisht 17%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të Komunës së Hanit të Elezit ka rezultuar në 15 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Raporti ynë ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, katër rekomandime janë zbatuar, shtatë ishin në proces dhe katër nuk janë adresuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe shtatë rekomandime, dhe brenda vitit 2017 katër nga to ishin zbatuar, dy ishin në proces dhe një nuk ishte adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 6 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- E gjetura** Për shkak të menaxhimit të pa mjaftueshëm të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar. Kjo tregon një mungesë të përqendrimit të personave përgjegjës në aplikimin e masave konkrete lidhur me zbatimin e tyre, që vijnë si rezultat i dobësive të identifikuar. Ne nuk kemi vërejtur se Komuna aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve.
- Rreziku** Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontroleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i mangësive të qeverisjes brenda Komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial.

Një ndër elementet kyçe të një qeverisje efektive të komunës është edhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Përgjigja efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve nuk është e kënaqshme. Kjo pjesë është trajtuar më detajisht tek kapitulli 'Progresi i zbatimit të rekomandimeve'.

Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, duke iu përgjigjur shumicës së pyetjeve me notë mesatare prej 2.69. Sipas pyetësorit komuna kishte dhënë përgjigje negative në shtatë pyetje nga gjithsej 106 sosh. Pyetjeve që kanë të bëjnë me regjistrimin e pasurive, ishin vlerësuar më notën maksimale, derisa në gjatë auditimit kemi vërtetuar se regjistrat e pasurisë jo financiare nuk janë të plota. Kjo do të thotë se menaxhmenti duhet të marrë parasysh çështjet të cilat nuk kanë arritur nivelin e pritur.

Komuna ka Planin Zhvillimor Komunal 2010-2025, gjithashtu gjatë vitit 2017, ka aprovuar Strategjinë për Zhvillimin Social Ekonomik 2018-2022.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, secili subjekti publik me buxhet 1 deri 3 milionë duhet të ketë një auditor të brendshëm.

Çështja 7 – Mungesa e themelimit të NJAB-së

- E gjetura** Komuna ende nuk ka siguruar themelimin e NJAB-së. Sipas UA 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e NJAB në sektorin publik, neni 3 pika 2.1 përcakton se subjekti publik me buxhet 1 deri 3 milionë duhet të ketë një auditor të brendshëm. Megjithëse, gjatë vitit 2017 ata kanë siguruar një auditim të brendshëm nga Ministria e financave.
- Rreziku** Mungesa e auditimit të brendshëm mund të rezultojë me vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos i identifikojë dhe reagojë me kohë ndaj parregullsive dhe dobësive të kontrollit.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të siguroj përbushjen e kërkesës ligjore, respektivisht të rekrutoj një auditor të brendshëm. Nëse kjo kërkesë nuk mund të realizohet, atëherë shërbimi i auditimit të brendshëm, duhet të vazhdojë të kryhet nga Ministria e Financave, apo ndonjë subjekt tjetër publik. Shërbimi i auditimit, do të mbështeste menaxhmentin në vendimmarrje dhe eliminim të dobësive.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara ishin të pamjaftueshme dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 8 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Si pasojë e kontrolleve të pamjaftueshme menaxheriale, dhe aprovimit të vonshëm të rishikimit të buxhetit nga Qeveria, një pjesë e buxhetit për investime kapitale ka mbetur e pa shpenzuar. Përveç kësaj komuna nuk ka mekanizma adekuate për menaxhimin e të arkëtueshmeve. Si pasojë ato po rriten nga viti në vit.

Komuna gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Ata kanë filluar me hartimin e regjistrit të rreziqeve nga disa drejtori, mirëpo nuk është kompletuar si proces. Po ashtu komuna nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në Theksim të Çështjes. Është e nevojshme që të ndërmerren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet për mos regjistrim të pasurisë në SIMFK dhe të paraqitjes së saktë në PVF.			Nuk janë marrë masa.
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se pas hartimit të një liste të rreziqeve me nivelet përkatëse. Përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut është deleguar tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi mbarëvajtjen e procesit.		Disa drejtori kanë filluar më përgatitjen e regjistrimit të rreziqeve, mirëpo ende komuna nuk ka një regjistër të plotë të rreziqeve.	
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të konsiderojë mundësinë e sigurimit të shërbimeve të auditimit të brendshëm, në mënyrë që të testoj përshtatshmërinë, efektivitetin dhe operimin e kontrolleve të brendshme të organizatës.	Po		
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike dhe janë identifikuar barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.		Niveli i shpenzimit të buxhetit ishte i lartë të të gjitha kategoritë, përveç kategorisë së investimeve kapitale.	

3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të inicioj një analizë të plotë pse janë aplikuar praktika të dobëta të prokurimit në këto raste dhe të zbatojë kontrole të shtuara të cilat sigurojnë se: prokurimet i reflektojnë nevojat; specifikacionet e tenderit i reflektojnë kërkesat aktuale të drejtorive. Në përgjithësi, kontrollet e prokurimit duhet të forcohen.	Po		
3.5.2 Kompensimet (Pagat dhe Mëditjet)	Kryetari duhet të rishikoj rregulloren e brendshme të aplikuar deri më tani nga komuna, dhe të korrigjoj të njëjtën në pajtim me rregulloren organike dhe ta aplikoj në mënyrë adekuate në mënyrë që të mos dëmtohet buxheti i komunës.	Po		
3.5.3 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të siguroj raportim të plotë të obligimeve dhe të forcoj kontrollet dhe disiplinën e zyrtarëve përgjegjës për të përcjellë faturat e pa paguara tek departamenti i financave. Për trajtimin e detyrimeve kontingjente në koordinim me Përfaqësuesin Ligjor të Komunës, duhet të ndërmerret një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar prioritetin e pagesave, duke iu shmangur ekzekutimeve direkt nga MF.	Po		
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.3 Pasqyrat financiare vjetore	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së Opinionit dhe të merren veprimet e duhura për t'i evituar gabimet në keq klasifikimin e shpenzimeve dhe mos regjistrimin e saktë të pasurive. Gjithashtu, duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			Nuk janë marrë masa.

2.1 Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Kryetari duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike për të identifikuar dhe eliminuar barrierat gjatë procesit.		Komuna ka përgatitur një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve ishte i lartë.	
2.2 Pyetësori i vet-vlerësimit -	Kryetari duhet të siguroj se është hartuar strategjia zhvillimore gjithëpërfshirëse duke përfshirë palët e interesit dhe duke llogaritur kostot për zbatimin e saj, si dhe lista e rreziqeve të plotësohet me masat që duhet të ndërmerren për të minimizuar dëmet në rast të ndodhjes së ndonjë rreziku.		Disa drejtori kanë filluar më përgatitjen e regjistrimit të rreziqeve, mirëpo ende komuna nuk ka një regjistër të plotë të rreziqeve.	
2.3.1 Planet strategjike	Kryetari duhet të miratoj një plan të përgjithshëm strategjik për komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbejë si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave.	Po		
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të siguroj se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2017.		Edhe pse raportimet rreth kontrolleve menaxheriale nuk kanë munguar, raportet mbi progresin fizik dhe operativ duhet të përmirësohen edhe më tutje.	
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të rishikoj mundësitë buxhetore që të formoj NJAB e cila do të kontribuonte më shumë në vlerësimin dhe përmirësimin e kontrolleve të brendshme. Në të kundërtën, këto shërbime vjetore të vazhdoj t'i kryej MF apo ndonjë komunë tjetër e afërm.			Nuk janë marrë masa.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të siguroj dhe të përcaktoj objektiva të qarta për përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në periudhat e ardhshme, dhe të vendos një monitorim sistematik mbi ekzekutimin e buxhetit të planifikuar, sidomos për projektet kapitale.		Niveli i shpenzimet të buxhetit ishte i lartë të të gjitha kategoritë, përveç kategorisë së investimeve kapitale.	
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të kërkojë arsyet përse softueri i blerë ka mbetur pasiv vite me radhë, dhe të siguroj se i njëjti do të vihet në funksion me qëllim që mbajtja e të dhënave të ofroj informata të mjaftueshme për secilin biznes apo të kërkoj një përmirësim në formatin ekzistues të mbajtjes së të dhënave në Excel. Gjithashtu, duhet të kërkoj veprime konkrete nga organet kompetente për ndalimin e atyre bizneseve të cilët nuk i janë përgjigjur obligimeve ndaj komunës.		Komuna ka përmirësuar raportimin e të arkëtueshmeve, mirëpo nuk ka krijuar mekanizma adekuate për mbledhjen e tyre.	
	Kryetari duhet të rishikoj rastet e mësipërme të faljes së borxheve dhe të siguroj se falja e borxheve bëhet vetëm për kategoritë e lejuara me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Para marrjes së vendimeve, rastet të shqyrtohen paraprakisht dhe të sigurohet se vendimet e marra janë në përputhje të plotë me ligjet apo rregulloret përkatëse.	Po		
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të forcoj kontrollat e procedimit të dhënave të personelit në sistemin e pagave dhe të siguroj marrjen e veprimeve të nevojshme për kategorizimin e drejtë të të punësuarve sipas klasifikimit të përcaktuar të gradave të pagave.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se zyra e prokurimit përmbledhë të gjitha kërkesat për blerje të njëjta për të mundësuar zhvillimin e procedurave të hapura të prokurimit. Kjo do të mundësonte një konkurrencë më të lartë dhe çmime më të favorshme për buxhetin e komunës.	Po		

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se komisioni i caktuar përkatës do të përshpejtoj dhe kompletoj punën e filluar më parë dhe do të dorëzoj raportin përfundimtar të rezultateve të regjistrimit. Në të kundërtën, të themeloj një komision të ri.		Gjatë vitit 2017 ishte bërë inventarizimi vetëm për inventarin në objektin e komunës dhe shtëpisë së kulturës dhe pjesërisht në QKMF kurse jo në objektet arsimore.	
3.2.2 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj	Kryetari duhet të siguroj se një praktikë e tillë do të ndërpritet, dhe të zbatohen kërkesat e rregulloreve financiare që të gjitha shumat e mbledhura në kesh, të depozitohen në bankë brenda afateve ligjore të përcaktuara.			Nuk janë marrë masa.
3.2.3 Te arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e të arkëtueshmeve. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative për inkasimin e tyre.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj se ekziston një raportim i drejtë dhe në kohë i të gjitha faturave të papaguara nga të gjitha departamentet, si dhe të siguroj se planifikimi i buxhetit bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkualuar në asnjë rast ndarjet buxhetore.		Ekziston një raportim i mirë i obligimeve, megjithëse ato janë rritur në raport me vitin paraprak.	

Shtojca III: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS, REPUBLIKA KOSOVA, REPUBLIC OF KOSOVA
СЕРБИЈА - ВЛАДА - GOVERNMENT
KOMUNA HANI I ELEZIT, OPŠTINA HANI I ELEZIT, MUNICIPALITY HANI I ELEZIT
№: 02, Nr. i Fide: 4953, Data: 19.06.2018
HANI I ELEZIT

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Hanit të Elezit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

 z. Rufki Suma

Kryetar i Komunës,

Data: 19 Qershor.2018, Hani i Elezit,

